

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E RENDIT PUBLIK

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

Nr. 1493 Dt. 16.05, 2001

Nr. 919 Dt. 22.05, 2001

MINISTRIA E DREJTËSISË

SHERBIMI INFORMATIV SHTETËROR

Nr. 2795 Dt. 15.05, 2001

Nr. 475 Dt. 09.04, 2001

URDHËR

Nr. ____ Date ____ .2001

PËR ORGANIZIMIN, BASHKËPUNIMIN DHE BASHKËRENDIMIN E PUNËS
SE KATËR ORGANEVE, MINISTRISË SE RENDIT PUBLIK, MINISTRISË SE
DREJTËSISË, PROKURORISË SE PËRGJITHSHME DHE SHËRBIMIT
INFORMATIV SHTETËROR

Ne mbështetje te nenit 102, pika 4 te Kushtetutës dhe ne zbatim te Kodit te Procedurës Penale, te ligjit nr.8737, dt. 12.02.2001 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Prokurorisë ne Republikën e Shqipërisë" dhe te ligjit nr.8391, dt.28,10.1998, "Për Shërbimin Informativ Shtetëror", nisur nga domosdoshmëria për organizmin e punës se katër organeve nga qendra ne baze, për te rritur efektivitetin e luftës kundër kriminalitetit dhe parandalimin e tij dhe me qellim normimin e kësaj detyre,

URDHËROJMË:

1. Ne mënyrë periodike një here ne tre muaj te behet mbledhja e përbashkët e katër organeve, Ministrisë se Rendit Publik, Ministrisë se Drejtësisë, Prokurorisë se Përgjithshme dhe Shërbimit Informativ Shtetëror, ku te merren ne analize e te diskutohen probleme te punës se luftës kundër kriminalitetit me qellim qe te ndërtohet një politike goditjeje sa me efikase, duke përcaktuar dhe drejtimet për te realizuar me sukses këtë lufte.

Me iniciativën e njëres pale, për probleme te caktuara, takimet mund të bëhen në çdo kohë. Konkluzionet e mbledhjeve dhe problemet e dala t'u bëhen të njohura në mbledhje të veçanta punonjësve të bazës të secilit organ sipas drejtimeve në mënyrë që nëpërmjet njohjes së tyre të përcaktohen masa konkrete për mënjanimin e të metave dhe përmirësimin e punës.

2. Drejtoritë e Policisë së Qarqeve e Komisarariatet e Policisë, Prokuroritë, Gjykatat dhe Sherbimi Informativ Shtetëror në rrethe, mbi bazën e një plani të miratuar çdo muaj, të organizojnë mbledhje pune të katër organeve, ku të parashtrihen dhe analizohen problemet e luftës kundër kriminalitetit, për të rritur efektivitetin e punës për goditjen e veprimtarisë kriminale.

Mbledhjet mujore të jene të përgatitura mirë, me tematike të caktuara pa përjashtuar këtu trajtimin e çështjeve konkrete që janë në ndjekje.

Në trajtimin e çështjeve të ndryshme secili organ ruan kompetencat e tij ligjore dhe kërkesat që i burojnë nga ligji, pa ndërhyrë në çështjet që ndjek njëri apo tjetri organ.

3. Objekt i punës së këtyre mbledhjeve, si në qendër dhe në baze të jene trajtimi dhe analizimi i çështjeve të tilla, si lufta kundër kriminalitetit në përgjithësi dhe e atij të organizuar në veçanti, sidomos i atyre kundër trafikut klandestin i makinave, drogës, armeve, vrasjeve, terrorit, prostitucionit, kontrabandës etj., me qëllim që të përcaktohen rrugët dhe detyrat konkrete për organizimin, bashkëpunimin e bashkërendimin midis katër organeve, për një luftë sa më efektive, duke përcaktuar dhe drejtimit e punës për ndjekjen hetimin dhe gjykimin e tyre sipas kompetencave që u caktojnë ligjet mbi të cilat ato veprojnë e funksionojnë.

4. Veç sa më sipër, takimet e titullarëve të jene të vazhdueshme dhe për çështje që kërkojnë bashkëpunim dhe bashkërendim dhe që nuk presin kohë për trajtim, të analizohen e të shtrohen për zgjidhje pa prituri mbledhjen e radhës. Takimet t'i shërbejnë koordinimit të punës ku secili kryen detyrat e tija të ngarkuara nga ligji.

5. Në zbatim të detyrave procedurale dhe të atyre të caktuara me ligj, të katër organet të ushqejnë me informacion dhe materiale, si për çështje konkrete e probleme të ndryshme që kanë në ndjekje, ashtu dhe për njohjen e gjendjes dhe veprimtarinë e elementit kriminal duke ruajtur sekretin.

6. Forcimi i bashkëpunimit ne punën e katër organeve, policia si organ i ndjekjes dhe ekzekutiv, Sh.I.Sh.-i si organ informacioni, Prokuroria si organ i procedimit dhe hetimit dhe gjykatat për dhënien e drejtësisë, t'i shërbejnë gjithmonë zbatimit drejte te ligjit për te rritur efektivitetin. e goditjes se veprimtarisë kriminale pa ndërhyrje ne kompetencat e njeri tjetrit.

Për nevoja pune dhe çështje konkrete te katër organet, bashkëpunojnë e ndihmojnë njeri tjetrin duke përcaktuar detyra te përbashkëta, ku secili vepron sipas detyrave e funksioneve te tyre ligjore, duke vene ne dispozicion materiale, forca e mjete për zgjidhjen e situatave e sqarimin e çështjeve ne ndjekje.

7. Ne mbledhjen mujore dhe takimet e herëpashershme te titullarëve krahas problemeve qe mendojnë te trajtojnë e te merren ne shqyrtim, te analizohen dhe çështje te cilësisë e te shpejtësisë ne gjykim, zvarritjet ne ekzekutimin e vendimeve te arrestit dhe urdhrave te dala dhe te nxjerra për personat qe janë ne kërkim, duke vene ne dukje te metat dhe dobësitë e nxjerre pergjegjesise për çdo organ, duke përcaktuar dhe drejtimet për përmirësimin dhe organizimin e punës.

8. Ne mbledhjet e organizuara krahas pranisë se titullarëve te katër organeve, sipas rendesise se problemit, mund te ftohen e te marrin pjese punonjës te sektorëve përkatës, sipas çështjeve e drejtimeve qe trajtohen.

9. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Urdhri ngarkohen te katër titullarët e organeve.

Ky urdhër hyn ne fuqi menjëherë.

MINISTRI I RENDIT PUBLIK
ILIR GJONI



PROKURORI I PERGJITHEM
ARBEN RAKIPI



MINISTRI I DREJTESISE
ARBEN IMAMI



KRYETARI I SH.I.SH. - it
FATOS KLOSI

